

VENDIM
Nr. 20, datë 18.1.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 298, DATË 20.4.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË TURIZMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 7, e kreut I, të vendimit nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Marrëdhëniet e punës të drejtorit të përgjithshëm dhe të punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar.”.

2. Për nëpunësit aktualë të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësit civil në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku